



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
KOMISIONI DISIPLINOR

V E N D I M

Nr. 2, datë 16.11.2021

Komisioni Disiplinor i Përmbarduesve Gjyqësorë Privatë i konstituuar më datë **10.2.2021** dhe përbërë nga:

Vangjel Kosta	Kryetar
Tedi Malaveci	Anëtar
Erind Mërkuri	Anëtar

mori në shqyrtim kërkesën me nr. prot. {....}, datë {....} “Përcjellje dokumentacioni për nisjen e procedimit disiplinor për përmbarduesin gjyqësor privat {....}{....}” të Ministrisë së Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj përmbarduesit gjyqësor privat {....}{....}.

Ministri i Drejtësisë, Etilda Gjonaj (Saliu), me urdhrin nr. {....}, datë {....}, krijoi një grup kontrolli, për kryerjen e kontrollit në adresën e përmbarduesit gjyqësor privat {....}{....}, prej ku rezultoi, sipas raportit të përcjellë, se përmbarduesi {....}{....} nuk ushtronte veprimtarinë në adresat e deklaruara, ndërkohë që ministria prej të gjitha ankesave ka evidentuar se njoftimet që mbanin nënshkrimin e përmbarduesit {....} {....}, nuk kishin në përmbajtje elementët formalë që duhet të ketë një akt që pasqyron një veprim përmbardimor.

Ministri i Drejtësisë, Etilda Gjonaj (Saliu), me urdhrin nr. {....}, datë {....}, ka urdhëruar “Për kryerjen e hetimit disiplinor pranë përmbarduesit gjyqësor privat {....}{....}”.

Kërkesa bazohej në gjetje dhe vlerësime ndaj veprimtarisë së përmbarduesit {....} {....}, që në raportin bashkëlidhur kërkesës dhe dokumentacionin pjesë përbërëse të tij, evidentoheshin se përbënin shkelje disiplinore. Raporti konstatohet se është përpiluar pas hetimit disiplinor kryer nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, që kishte nisur për shkak të kërkesave dhe ankesave të paraqitura nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Agjencisë së Trajtimit të Kreative, shtetasve {....} dhe {....} {....}, {....} {....}, {....} {....}, {....} {....}, {....} {....}, {....} {....}.

Referuar kërkesës dhe gjetjeve të pasqyruara në raport, motivacioni ligjor mbi të cilin bazohet kërkesa për nisjen e procedimit disiplinor, referon në përcaktimet e germës “b” të pikës 1 të nenit 14, pikës 3 të nenit 58, si dhe nenit 61 të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbardimor gjyqësor privat”.

Komisioni Disiplinor e zhvilloi veprimtarinë e tij bazuar në ligjin nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat” dhe urdhrin nr. 189, datë 22.6.2020 të ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores për konstituimin, organizimin, funksionimin dhe shpërblimin e anëtarëve të komisionit disiplinor të përmbartuesve gjyqësorë privatë”, duke respektuar plotësisht të drejtat e përmbartuesit {....} {....} dhe zbatuar me rigorozitet parimet e hetimit administrativ, me qëllim vlerësimin e kërkesës dërguar për shqyrtim para Komisionit Disiplinor, nga ministri i Drejtësisë.

Kërkesa me nr. prot. {....} datë {....}, për fillimin e procedimit disiplinor dhe vetë raporti që shoqëronte kërkesën, i është njoftuar paraprakisht përmbartuesit {....} {....} në datën {....} me shkresën nr. {....} prot., “Njoftim për paraqitje në seancë dëgjimore”, sikundër dhe nëpërmjet njoftimit elektronik në adresën elektronike zyrtare të vetëdeklaruar pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë.

I. Konflikti i interesit

1. Të tre anëtarët e këtij Komisioni, në fillim të procesit, deklaruan se nuk ishin para ndonjë pengese ligjore në shqyrtimin e këtij procedimi disiplinor, nuk ndodheshin në kushtet e konfliktit të interesit dhe/ose nuk kishin asnjë pengesë ligjore në shqyrtimin e plotë, në mënyrë të paanshme dhe objektive të këtij procedimi disiplinor.

II. Baza ligjore e vendimmarrjes

1. Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë (Parimet e përgjithshme dhe hetimi administrativ);
2. Ligji nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”;
3. Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë;
4. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;
5. Udhëzimi i përbashkët nr. 385/7, datë 28.6.2017, i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbartimor gjyqësor privat”;
6. Urdhri nr. 3851, datë 8.5.2009, i ministrit të Drejtësisë (në fuqi në kohën kur pretendohet se janë kryer veprimet e konsideruara si shkelje) dhe urdhri nr. 136, datë 27.4.2020, i ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e Kodit të Etikës së Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë”;
7. Urdhri nr. 189, datë 22.6.2020, i ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores për konstituimin, organizimin, funksionimin dhe shpërblimin e anëtarëve të komisionit disiplinor të përmbartuesve gjyqësorë privatë”.

III. Mbledhjet e komisionit disiplinor, qëndrime dhe komunikime në procesin disiplinor

1. Komisioni Disiplinor, në datë {....}, zhvilloi mbledhjen e parë si seancë dëgjimore me përmbartuesin {....} {....}.

2. Mbledhjen e drejtoi kryetari i Komisionit Disiplinor z. Vangjel Kosta, i cili e ftoi përmbartuesin {....} {....} të shprehej në lidhje me anëtarët e Komisionit. Përmbartuesi deklaroi se nuk kishte asnjë kundërshtim me përbërjen e Komisionit Disiplinor.

3. Gjatë seancës dëgjimore, ishte i pranishëm përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë, z. {....} {....}, i cili depozitoi përpara Komisionit urdhrin nr. {....}, datë {....}, të ministrit të Drejtësisë “*Për përfaqësimin në seancën dëgjimore pranë Komisionit Disiplinor*”.

4. Përmbauesi {....} {....} deklaroi se ishte njohur me të gjithë elementët e raportit të përpiluar nga punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë dhe shprehu qëndrimin se kishte pasur kohën e mjaftueshme për t’u njohur me dokumentacionin dhe për t’u përgatitur për mbrojtjen e tij. Pavarësisht këtij deklarimi në fillim të seancës dëgjimore, përmbauesi {....} {....}, në vijim të saj, nuk arriti të japë shpjegime për çështjet e ngritura në raport, duke u justifikuar se kishte marrë dijeni mbi raportin vetëm një ditë më parë.

4.1 Në këto kushte, Komisioni, duke vlerësuar t’i lërë kohën e nevojshme dhe të mjaftueshme përmbauesit {....} {....}, për t’u përgatitur dhe njohur me detaje mbi çështjet e ngritura në raport, me vendim të ndërmjetëm vendosi të ndërpresë seancën dëgjimore duke caktuar vijimin e saj në datën 3.11.2021.

5. Seanca e dytë dëgjimore me përmbauesin {....} {....} u zhvillua më datë {....}, ora {....}.

6. Në seancë u paraqit vetëm përmbauesi {....} {....}, ndërsa përfaqësuesi i ministrit të Drejtësisë, z. {....} {....}, pavarësisht se kishte marrë dijeni rregullisht nga prezenca në seancën e datës {....}, nuk u paraqit.

7. Përmbauesi {....} {....} depozitoi para Komisionit parashtrime me shkrim, që mbanin datën 3.11.2021, në lidhje me procedimin disiplinor, ndërkohë që iu përgjigj dhe pyetjeve të anëtarëve të Komisionit Disiplinor.

IV. Në lidhje me faktet e dala gjatë seancës dëgjimore

Gjatë seancës dëgjimore me përmbauesin {....} {....}, Komisioni Disiplinor ka evidentuar të dhëna tepër shqetësuese, si vijon:

1. Kërkesës për sqarime mbi faktin e mospërbushjes së detyrimeve tatimore, siç del nga dokumentacioni i përcjellë nga Ministria e Drejtësisë, përmbauesi iu përgjigj se, citim nga transkriptimi i seancës së regjistruar: “*S’është se kam bërë noj punë dhe... nuk është se kam punuar faktikisht, ça kam bërë noj heqje sekuestroje për noj gjë kshu, nuk është se kam pasur noj zyrë... Mora një zyrë e lashë s’e përballoja dot*”.

2. Përmbauesi {....} {....} deklaroi duke pranuar se nuk kishte njoftuar Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë për adresën e ushtrimit të aktivitetit, apo ndryshimin e saj.

3. Përmbauesi {....} {....} deklaroi që kishte bërë “*ndonjë sekuestro*” dhe nuk dispononte asnjë nga këto akte, sipas detyrimit që ka nga legjislacioni në fuqi, dhe as nuk ia kishte përcjellë informacionin e kërkuar Ministrisë së Drejtësisë.

4. Përmbareuesi {....} {....} deklaroi se, ka punuar te zyra {....}, (duke iu referuar shoqërisë tregtare “{....}” sh.p.k.), sipas fjalëve të cituara nga transkriptimi i seancës së regjistruar, “*ku punon ai {....} {....}*” (duke iu referuar shtetasit {....}{....}, ish-përmbareues gjyqësor privat).
5. Përmbareuesi {....} {....} deklaroi sipas citimit marrë nga transkriptimi i seancës së regjistruar se, “*Thjesht mo’ kam bërë një biz... biznes kshu, isha i papunë në atë kohë, s’punoja dhe e kërkova unë si punë, kundrejt një rroge, një pagese dhe vetëm thjesht me bo’ heqjet e sekuestrove*”.
6. Lidhur me shkresa që përmbanin nga ana formale nënshkrimin e përmbareuesit {....} {....}, një pjesë e të cilave pa protokoll dhe datë, përmbareuesi deklaroi para Komisionit Disiplinor, se ato, citim nga transkriptimi i seancës së regjistruar: “*Mund të jetë e parregullt se mua si fotokopje më duket mua kjo vula, ku di unë ç’a është*” dhe se nuk kishte bërë apo kryer ndonjë herë ekzekutim. Ai pranoi se, citim nga transkriptimi i seancës së regjistruar: “*Firma, vula këto... mund të jetë firma ime po mund ta kenë kopjuar ata ku di unë ç’a kanë bërë ata tani. Unë s’e di*” dhe me “ata” iu referohej zyrës së “{....}”, përmes qëndrimit se: “*Po këta të zyrës mo, këta që çojnë këto letrat. Kush i ka çuar. Nuk e di kush i ka çuar*”.
7. Përmbareuesi mbajti qëndrimin se nuk ka bërë komunikime nga ato që përmban dosja e referuar nga Ministria e Drejtësisë. Sipas tij, citim nga transkriptimi i seancës së regjistruar: “*Unë me koshiencën time kam bërë vetëm heqje sekuestro. Këto budalliqet e tjera unë s’i njoh fare. Unë... më kanë thirr Lenc kemi për të heq sekuestro, ka ardhë kreditori ka paguar, a e bëjmë e bëjmë, kundrejt një pagese që kam marrë. [...] Ata thjesht mund të kenë pasur dosje të mbartura... Ku di unë tani se dhe unë nuk është se jam.... [...] Kanë pas dosje të bllokuara, kanë dash’ me i liruar. Ku di unë tani. Kanë kreditorët e vetë a, ç’a kanë pasur...*”.
8. Përmbareuesi pranoi se nuk ka administruar asnjë dosje përmbareimore, dosjet kanë pasur sekuestro nga përmbareues të tjerë dhe dosjet i dispononte shoqëria “{....}” dhe se, për ato akte që pranon se ka nënshkruar si heqje sekuestroje, nuk ka pyetur, thjesht ka qenë i kënaqur me rrogën që ka marrë.
9. Përmbareuesi {....} {....}, gjatë seancës dëgjimore, deklaroi se ka lënë vulën e përmbareuesit “*tek ata çunat*”, për mbi 1 (një) vit. Duke u përpjekur të evidentojë periudhën e saktë dhe konkrete kohore, përmbareuesi pranoi se këtë veprim e ka kryer rreth 6 (gjashtë) muaj në vitin 2018 dhe 6 (gjashtë) muaj në vitin 2021.
10. Në përfundim të seancës dëgjimore, përmbareuesi {....} {....}, deklaroi, citim nga transkriptimi i seancës së regjistruar: “*E di, ata janë një studio me probleme nga të cilat arriti puna ime deri këtu tani se unë s’kisha pse të vija këtu sot me juve, po ajo studio ishte e gabuar dhe iku kshu rastësi kjo punë. Tani unë s’e di*”.
11. Përmbareuesi {....} {....} këmbënguli se, kjo dakordësi ishte vetëm për “*heqje sekuestroje*” dhe për asnjë lloj akti tjetër.
12. Përmbareuesi pranoi se nuk ka paguar as detyrimet e anëtarësisë pranë Dhomës Kombëtare të Përmbareuesve Gjyqësorë Privatë, pasi kujtonte se pagesën e kishin kryer “ata” të shoqërisë “{....}” ku punonte, por më pas ka kuptuar që “ata” nuk e kanë përmbushur këtë detyrim për të.

13. Në përfundim, përmbaruesi kërkoi mundësinë e një mase të lehtë, duke u angazhuar se nuk do të ndodhnin më këto që kishin ndodhur me aktivitetin e tij dhe se për të ky ishte një mësim, pasi ai vetë nuk kishte abuzuar, por se abuzimi ishte bërë nga ana e “atyre”, të cilëve u kishte besuar vulën, duke shkuar “me vulë në xhep”.

V. Në lidhje me gjetjet, konstatimet dhe shkeljet e konstatuara në raportin e Ministrisë së Drejtësisë

1. Komisioni Disiplinor, vlerëson se faktet e evidentuara gjatë seancës dëgjimore me përmbaruesin {...} {...}, të pasqyruara qartë nga deklaratimet e tij, por dhe të reflektuara dukshëm në dokumentacionin e përcjellë nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, bashkë me kërkesën për procedim disiplinor, janë tepër flagrante, në kufijtë jo vetëm të shkeljeve të rënda dhe të përsëritura disiplinore, por të konsumimit të disa veprave penale, që sipas të dhënave, mund të jenë kryer në bashkëpunim, në cenim të interesave të qytetarëve në masë.

2. Nga ana formale e paraqitjes së raportit nga ministri i Drejtësisë, pavarësisht shkeljeve tepër të rënda, Komisioni në respektim të parashikimeve ligjore në fuqi, u ndal në verifikimin e respektimit të afateve në përcjelljen e kërkesës për procedim disiplinor.

2.1 Komisioni konstaton se, Ministria e Drejtësisë ka disponuar të dhëna shqetësuese për të cilat duhet të ishte vënë në lëvizje menjëherë, që në periudhën prill - qershor 2020, jo vetëm nga ankesat e qytetarëve, por edhe nga institucionet shtetërore, si ato që ka administruar përmes shkresës me nr. {...} prot., datë {...} të Drejtorisë së Përgjithshme Policisë.

2.2 Ministria e Drejtësisë është vendosur në dijëni të fakteve të rënda lidhur me aktivitetin e këtij përmbaruesi të licencuar dhe ka ndërmarrë një proces kontrolli/verifikimi që në datën 18.6.2020, përmes urdhrin nr. 186 të ministrit të Drejtësisë.

2.3 Prej këtij momenti, Ministria e Drejtësisë edhe pse kishte fakte konkrete të shkeljeve flagrante, ka lejuar vijimësinë dhe vazhdimësinë e afateve ligjore për të përcjellë çështjen për procedim disiplinor dhe për marrjen e masave konkrete nga Komisioni Disiplinor.

2.4 Ministria e Drejtësisë ka vijuar të administrojë të dhëna edhe përgjatë vitit 2021, që lidhen kryesisht me të njëjtën tipologji problematike, ndërkohë që hetimin disiplinor e ka filluar vetëm në datën {...}, përmes urdhrin nr. {...} të ministrit të Drejtësisë, ndryshuar me urdhrin nr. {...}, datë {...}, duke theksuar se në pikën 2 të urdhrin është urdhëruar “*procesi i hetimit të kryhet brenda 60 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij urdhri*”, pra brenda datës {...}.

2.5 Në çdo rast, në kushtet kur raporti me nr. prot. {...} është përfunduar më datë {...}, ndërsa urdhri nr. {...}, datë {...} për nisjen e procedimi disiplinor është nxjerrë më datë {...}, atëherë ky urdhër është nxjerrë jashtë afatit 6-mujor, nga dita e marrjes së vendimit/urdhrin të ministrit për fillimin e hetimit.

2.6 Këto tejkalime afatesh, përpara të dhënave kaq flagrante, ashtu si evidentohen qartë në këtë procedim disiplinor, vënë ministrin e Drejtësisë para detyrimit për të evidentuar përgjegjësitë

konkrete brenda strukturave dhe nëpunësve përgjegjës të Ministrisë së Drejtësisë, që me pakujdesi, apo në forma të tjera dashjeje, mund dhe kanë lejuar vijueshmërinë dhe vazhdimësinë e këtyre afateve, duke nxjerrë procedimin disiplinor nga rruga e ligjshmërisë.

3. Komisioni Disiplinor vlerëson se, Ministria e Drejtësisë, sipas ligjit nr. 26/2019, është e lidhur me dy afate.

3.1 Afat 2-vjeçar, si një afat i përgjithshëm, i cili pengon Ministrinë e Drejtësisë që të fillojë një procedim disiplinor, nëse nga momenti i shkeljes deri në konstatimin e saj, kanë kaluar të paktën 2 vjet. Në këtë rast, procedimi administrativ nuk mundet që të fillojë.

3.2 Nga ana tjetër, Ministria e Drejtësisë ka të paktën 6 muaj kohë për zhvillimin e hetimit të saj administrativ.

3.3 Me marrjen e një ankesë (kur vepron mbi kërkesat e subjekteve të tjera), ose kur merr të dhëna kryesisht, Ministria e Drejtësisë, kryen fillimisht një procedurë verifikimi, e cila sipas nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 26/2019, nuk mund të jetë më e gjatë se 3 muaj. Gjatë kësaj periudhe, Ministria e Drejtësisë çmon nëse ka pasur shkelje dhe hap procesin hetimor administrativ, apo nëse ankesa dhe/apo të dhënat nuk tregojnë për asnjë shkelje dhe për rrjedhojë çështja arkivohet. Në këtë rast, këto veprime paraprake nuk janë hetim administrativ i mirëfilltë në funksion të procedimit disiplinor dhe për rrjedhojë nuk mundet që ta pezullojnë afatin e parashkimit, parashikuar nga neni 85, pika 2 e ligjit nr. 26/2019. Përkundrazi, në momentin që merret vendimi për fillimin e hetimit administrativ, atëherë afati 2-vjeçar pezullohet.

3.4 Për sa i përket afatit 6-mujor, ky afat, në përputhje me parashikimet e nenit 56 të Kodit të Procedurave Administrative fillon nga e nesërmja e vendimit të Ministrisë së Drejtësisë për fillimin e hetimit disiplinor dhe përfundon në të njëjtën ditë, të muajit të gjashtë. Sipas nenit 61 pika 3 e ligjit nr.26/2019, ministri i Drejtësisë, për shkaqe të përcaktuara, mund ta zgjasë këtë afat edhe për 6 muaj të tjerë. Duke qenë se në këtë rast kjo e drejtë e ministrit nuk është ushtruar, atëherë Komisioni, vlerëson të mos ndalet në trajtimin e këtij rasti, pasi ka rënë në dekadencë.

4. Bazuar në analizën e mësipërme, Komision Disiplinor është i detyruar të pranojë faktin se, për shkeljet e faktuara, përcjellja e tyre pranë Komisionit është bërë me vonesë në këtë procedim disiplinor.

VI. Konkluzionet e procesit disiplinor

Pas parashtrimeve dhe analizës ligjore kryer në kuadër të hetimit administrativ ndaj veprimtarisë së përmbaaruesit {...} {...}, Komisioni Disiplinor arrin në konkluzionin se, duke marrë në konsideratë dhe parasysh rrethanat e reja që dolën përgjatë zhvillimit të procesit administrativ dhe që kanë lidhje të drejtpërdrejtë e të rëndësishme me trajtimin e plotë të çështjes, nga analiza e kryer fakteve dhe provave të administruara në këtë proces administrativ, në mbështetje të nenit 74, pika 3 dhe 5, nenit 76 pika 2, germa b) dhe nenit 80, pika 1), germa d) të ligjit nr. 26/2019 “*Për shërbimin përmbaarimor gjyqësor privat*”, Komisioni Disiplinor,

VENDOSI:

1. T'i kthejë çështjen ministrit të Drejtësisë, në mënyrë që të bëhen hetime shtesë lidhur me faktet e reja të dala në seancat e Komisionit Disiplinor, pa pezulluar procesin disiplinor.
2. Hetimet shtesë, të kryhen mbështetur ekskluzivisht në elementët deklarativë të përmbarduesit {...} {...}, të fiksuara dhe transkriptuara nga seanca dëgjimore zhvilluar më datë {...}.
3. Të kryhet hetim shtesë në lidhje me verifikimin e ankesave, dokumenteve dhe/ose kërkesave që përmbajnë informacion mbi veprimet e përmbarduesit {...} {...} për vitin 2021.
4. Hetimet shtesë lidhur me verifikimin e fakteve të reja, që mund të përbëjnë shkelje të dispozitave të ligjit përtej sanksioneve disiplinore, por atyre me karakter penal të kryhen brenda afatit 15-ditor, nga e nesërmja e marrjes dijeni të këtij njoftimi.
5. Të vendosen menjëherë në dispozicion të ministrit të Drejtësisë, materialet provuese që përmbajnë faktet dhe provat që duhet të vlerësohen menjëherë nga një hetim shtesë dhe qëndrim adekuat bazuar mbi to.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i njoftohet me shkrim ministrit të Drejtësisë nga ana e Dhomës Kombëtare të Përmbarduesve Gjyqësorë Privatë.

Anëtar

Erind MËRKURI

Anëtar

Tedi MALAVECI

Kryetar

Vangjel KOSTA